

Çfarë ndodh nëse unë e thërras policinë?

Normalisht policia shkon vetë i dytë në vend. Personat e përfshirë ndahen dhe intervistohen për situatën. Personi që ka thirrur, normalisht nuk intervistohet. Pastaj policia heton se çfarë hapash të tjerë janë të nevojshme për mbrojtjen e personit të prekur nga dhuna. Ajo ka këto mundësi¹:

- Në rast të lëndimeve ajo organizon ndihmë mjekësore.
- Dëbimi dhe largimi: Policia mund ta ndalojë personin që ushtron dhunë që të kthehet në banesën e përbashkët. Dëbimi vlen për 20 ditë maksimumi.

Policia mund t'i ndalojë autorit të qëndrojë në afërsi të vendbanimit, të vendit të punës ose shkollës së personave në fjalë (viktima, fëmijë) dhe të ketë kontakt me ta. Nëse personi i dhunshëm nuk i respekton ndalimet, ai bëhet i dënueshëm.

Personi i prekur nga dhuna mund të kërkojë tek gjykata një zgjatje të masave mbrojtëse. Vendi i këshillimit për ndihmën e viktimave informon mbi të vepruarit

- Arrest: Policia mund ta ndalojë personin e dhunshëm deri në 24 orë. Për shembull, nëse ai e kundërshton dëbimin nga banesa. Ose nëse ai është një rrezik akut për një person tjetër.
- Strehë mbrojtëse: Policia mund ta çojë personin e prekur, me ose pa fëmijë, në një strehë mbrojtëse.

Çfarë ndodh, nëse unë thërras tek një qendër këshillimi?

- Nëse dëshiron, ti mund t'i përshkruash vëzhgimet e tua në mënyrë anonime.
- Këshilltaret e qendrës së këshillimit i nënshtrohen detyrimit për mbajtjen sekret. Kjo do të thotë se ato nuk lejohen që të informojnë asnjërin për bisedimet.
- Pas telefonatave nuk do të ndërmerret asnjë hap tjetër, nëse nuk dëshirohet
- Qendrat e këshillimit mund të të ndërmjetësojnë në qendra të tjera të këshillimit.

¹ «Informationen über Häusliche Gewalt, Unterstützung und Massnahmen» (Informacione për dhunën shtëpiake, mbështetjen dhe masat) BIG, 2021